



**Shkalla më e lartë e shpenzimit të buxhetit është shënuar në kategorinë e pagave, 97 për qind e buxhetit, kurse më e ulta në kagorinë e investimeve kapitale, ku janë shpenzuar vetëm 25.7 për qind e mjeteve buxhetore**

pasqyrat financiare dhe raporti i auditimit, por ai po injoron KPF-në, e vërejtjet tona nuk kemi ku t'i paraqesim", ka thënë Aliu. Por, sipas Skënderbe Hebibit, kryesues i KK-së, mosprezenca e kryetarit në mbledhjen e KFP-së është e arsyeshme, pasi ai ka angazhime të tjera dhe të gjitha vërejtjet apo propozimet mund t'i përcillen përmes nënkryetarit, i pranishëm në takim.

**DRENAS, 28 KORRIK** - Komuna e Drenasit, perkatesisnt Drejtoria e Bujqësisë, ka ndihmuar fermerët që kanë lopë qumështore me nga një makinë mjelëse. Drejtori i Bujqësisë, Skënder Hasi, ka treguar se nga subvencionet e Komunës janë ndarë 80 makina mjelëse për fermerët që kanë më shumë se 5 krerë lopë.

"Edhe këtë vit kemi menduar t'i ndihmojmë fermerët që kanë krerë të lopëve me nga një makinë mjelëse për 80 fermerë. Janë përfshirë të gjithë fermerët që i kanë plotësuar kriteret e konkursit, ka thënë Hasi. Sipas tij, makinat mjelëse janë të sofistikuar dhe më të avancuara. Ato arrijnë t'i mjinin deri në 20 krerë lopë gjatë një dite. Komuna e Drenasit, para disa muajsh ka ndihmuar 40 fermerë me nga një serë për mbjellje fidanesh. (B.D.)

**EKZEKUTIVI I LIPJANIT PËRBALLET ME KRITIKA NË FUSHËN E SHËNDETËSISË**

# Shoqëria civile rekomandon investime të shpejta në shëndetësi

**Arian Duriqi**

**LIPJAN, 28 KORRIK** - Ekzekutivi i Lipjanit është përballur me kritika të shumta nga shoqëria civile e kësaj komune, të shtunën, teksa pas tyre edhe është rekomanduar për investime të shpejta në këtë fushë. Në të vërtetë, ka qenë OJQ Youth Association for Human Rights (YAHR) që ka shprehur shqetësimin dhe brengën për investime të pamjaftueshme deri tashti në shëndetësi. "Nuk është investuar mjaft nga ana e ekzekutivit të komunës së Lipjanit në sektorin e shëndetësisë dhe ne kërkojmë që gjatë planifikimeve buxhetore për vitin e ardhshëm 2013 që të planifikohet dhe investohet me shumë", ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR. Sipas të dhënave zyrtare, ndërkaq, në Komunën e Lipjanit funksionon një QKMF, 4 qendra ndihmëse që quhen si QMF dhe 6 ambulanta të mjekësisë familjare. Kurse, vetëm

në QKMF-në e Lipjanit punohet me orar 24 orësh, derisa në QMF-të ndihmëse punohet pesë ditë në javë me nga 12 orë në ditë. Tri ambulanta punojnë vetëm dy ditë në javë me tetë orë në ditë. Sipas shifrave zyrtare, ndërkaq, del po ashtu se në QKMF-në e Lipjanit gjatë periudhës gjashtë mujore të këtij viti ka pasur mbi 80 mijë vizita nga pacientet të ndryshëm, kurse vetëm në njësinë e emergjencës ka pasur mbi 20 mijë shërbime të ndryshme. Krasniqi nga YAHR-i duke përllogaritur numrin e vizitave të pacientëve dhe investimet kapitale gjatë periudhës tre vjeçare, ka konstatuar se megjithatë duhet kushtuar më shumë rëndësi për shëndetësinë. "Duke i marrë parasysh të gjitha faktete dhe statistikatat konstatojmë se duhet kushtuar më shumë rëndësi nga ana e ekzekutivit të komunës së Lipjanit në sektorin e shëndetësisë primare, në përmirësimin e infrastrukturës dhe në ofrimin e shërbimeve të



**Ndërkohë që OJQ Youth Association for Human Rights (YAHR) ka shprehur shqetësimin për investime të pamjaftueshme deri tashti në shëndetësin e Lipjanit, autoritetet komunale e kanë pohuar të kundërtën, duke premtuar edhe investime të tjera në këtë fushë**

ndryshme shëndetësore gjatë periudhës së ardhshme", ka thënë ai. Ndërkohë që, lidhur me pohimet dhe rekomandimet që kanë ardhur nga shoqëria civile e Lipjanit, autoritetet komunale e deklarojnë të kundërtën. Shprehin gatishmëri për më shumë investime, por thonë se nuk qëndron puna siç përshkruhet nga YAHR-i. "Viti i kaluar ishte përshkruar me një intensitet të lartë në investimet kapitale duke filluar ne QKMF-ja në Lipjan, kurse renovimi i kësaj qendre pati kushtuar rreth 70 mijë euro. Po ashtu është rinovuar AMF-ja në Sllovi, derisa në Smallushë ishte ndërtuar një Ambulancë e Mjekësisë Familjare. Marrë në përgjithësi situata nuk është e tillë çfare po përshkruhet, mirëpo prapë se prapë ne jemi të hapur për të pranuar rekomandime dhe këshilla që çojnë përpara shëndetësinë në këtë komunë", ka thënë ai.